



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës :** KSC-BC-2020-06

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 18 dhjetor 2025

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Paraqitjen e Kundërprovave**

---

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Luka Mishetiç

**Mbrojtjes së Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Rodni Dikson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagendra

**TRUPI GJYKUES II** (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 127(2)(d), 133, 137 dhe 138 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 3 nëntor 2025, Mbrojtja e Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi” dhe “Mbrojtja e Krasniqit”) paraqitën për pranim si prova, ndër të tjera, tri materiale (bashkërisht, “materialet”) të lidhura me sekuestrimin e një kompjuteri në banesën e z. Krasniqi (“kompjuteri”), (“Mocioni i Krasniqit për Prova Jogojore”).<sup>1</sup>
2. Më 1 dhjetor 2025, Trupi Gjykues i pranoi materialet si prova (“Vendimi mbi Provat Jogojore të Krasniqit”).<sup>2</sup>
3. Më 2 dhjetor 2025, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“Mbrojtja e Thaçit”) dhe Mbrojtja e Krasniqit përfunduan paraqitjen e provave përkatëse të tyre sipas rregullës 131.<sup>3</sup>
4. Më 5 dhjetor 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) i kërkoi Trupit Gjykues që ta lejonte të paraqiste kundërprova dhe kërkoi pranimin e tyre (“Kërkesa”).<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> F03556, Mbrojtja, *Kërkesa e Dytë e Mbrojtjes së Krasniqit për Pranimin e Provave Jogojore*, 3 nëntor 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. *Shih konkretisht*, Shrojcën 1, materialet 115 (DJK01962-DJK01963), 123 (113365-113374), 124 (113728-113734).

<sup>2</sup> F03602, Trupi Gjykues, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* (“Vendimi për Provat Materiale Jogojore të Krasniqit”), 1 dhjetor 2025, para. 91, 95(e).

<sup>3</sup> F03609, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes së Thaçit sipas Rregullës 131*, 2 dhjetor 2025; F03611, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes së Krasniqit për Mbylljen e Paraqitjes së Provave sipas Rregullës 131*, 2 dhjetor 2025.

<sup>4</sup> F03616, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Paraqitjen dhe Pranimin e Kundërprovave*, 5 dhjetor 2025, me Shtojcën 1, konfidenciale.

5. Më 11 dhjetor 2025,<sup>5</sup> Mbrojtja e Krasniqit u përgjigj ("Përgjigjja").<sup>6</sup>
6. Më 12 dhjetor 2025, ZPS-ja u kundërpërgjigj ("Kundërpërgjigjja").<sup>7</sup>

## II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja kërkon leje për paraqitjen e: (i) një tabele me informacion lidhur me materialet në listën e provave materiale të marra nga kompjuteri ("Tabela");<sup>8</sup> dhe (ii) shënimit zyrtar përkatës lidhur me dy raporte forenzike, materialet 123 dhe 124, të pranuar përmes Vendimit mbi Provat Jogojore të Krasniqit ("shënimi zyrtar"), (bashkërisht "provat e propozuara").<sup>9</sup> ZPS-ja parashtron se provat e propozuara duhet të pranohen në rrethana të jashtëzakonshme pasi ato janë: (i) me fushëveprim të kufizuar, të llojit dokumentar, dhe lidhen me një aspekt të veçantë që buron drejtpërdrejt nga provat e Mbrojtjes të pranuar para pak kohësh;<sup>10</sup> (ii) në interes të drejtësisë;<sup>11</sup> dhe (iii) të pranueshme.<sup>12</sup>
8. Mbrojtja e Krasniqit e kundërshton pjesërisht Kërkesën.<sup>13</sup> Mbrojtja e Krasniqit parashtron se Kërkesa nuk përmbush standardin ligjor që rregullon paraqitjen e kundërprovave sipas rregullës 133.<sup>14</sup> Konkretisht, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se ZPS-ja nuk ka demonstruar se: (i) provat e propozuara janë

---

<sup>5</sup> CRSPD953, *Mesazh elektronik i Trupit Gjykses drejtuar palëve dhe pjesëmarrësve në lidhje me F03616 - Përshpejtim i Afateve për Parashtrime*, 8 dhjetor 2025, konfidencial.

<sup>6</sup> F03620, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit dhe Veselit ndaj 'Kërkesës së Prokurorisë për Paraqitjen dhe Pranimin e Kundërprovave (F03616)'*, 11 dhjetor 2025, konfidenciale.

<sup>7</sup> F03624, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj 'Përgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit dhe Veselit ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Paraqitjen dhe Pranimin e Kundërprovave' (F03620)*, 12 dhjetor 2025.

<sup>8</sup> Shtojca 1 e Kërkesës, (SPOE00408881-SPOE00408890, f. SPOE00408883-SPOE00408890); Kërkesa, para. 1, 3(a). *Shih gjithashtu* Paketën e Nxjerrjes 1839 (SPOE00408881-SPOE00408890).

<sup>9</sup> Shtojca 1 e Kërkesës, (SPOE00408881-SPOE00408890, f. SPOE00408881-SPOE00408882); Kërkesa, para. 1, 3. *Shih gjithashtu* Paketën e Nxjerrjes 1839 (SPOE00408881-SPOE00408890).

<sup>10</sup> Kërkesa, para. 2.

<sup>11</sup> Kërkesa, para. 2, 5.

<sup>12</sup> Kërkesa, para. 6. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 2.

<sup>13</sup> Kërkesa, para. 2, 14, 19-22, 23.

<sup>14</sup> Përgjigjja, para. 1.

kundërprova;<sup>15</sup> (ii) rrethanat e jashtëzakonshme do të justifikonin pranimin e provave të propozuara në këtë fazë të vonë;<sup>16</sup> dhe (iii) pranimi i provave të propozuara është në interes të drejtësisë.<sup>17</sup> Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshton pranimin e pjesës së provave të propozuara që jep informacionin që ka të bëjë me shtatë materiale tashmë të pranuar të renditura në materialin 124.<sup>18</sup> Megjithatë, Mbrojtja e Krasniqi kundërshton pranimin e pjesës tjetër të provave të propozuara me arsyetimin se ato përfshijnë informacion të lidhur me materiale që nuk janë pranuar.<sup>19</sup> Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") i bashkohet Mbrojtjes së Krasniqit për pikën e fundit.<sup>20</sup>

9. ZPS-ja përgjigjet se pranimi vetëm i faqes së fundit të tabelës për të cilën Mbrojtja e Krasniqit nuk ka kundërshtim, do të zbehte relevancën e provave të propozuara.<sup>21</sup> ZPS-ja nuk kundërshton heqjen e shënimeve në provat e propozuara që lidhen me dokumente që nuk janë pranuar në këtë proces.<sup>22</sup> Megjithatë, ZPS-ja parashtron se pjesa e mbetur e provave të propozuara në tërësi është e domosdoshme për të dhënë informacion në lidhje me parashtrimet e palëve dhe vlerësimin e Trupit Gjykues për materialet e sekuestruara nga kompjuteri.<sup>23</sup> ZPS-ja rithekson se Trupi Gjykues duhet ta lejojë ZPS-në të paraqesë për pranim, dhe të pranojë, provat e propozuara në tërësinë e tyre.<sup>24</sup>

---

<sup>15</sup> Përgjigjja, para. 1, 10-13, 21.

<sup>16</sup> Përgjigjja, para. 1, 5-9, 21.

<sup>17</sup> Përgjigjja, para. 1, 15, 18, 21.

<sup>18</sup> Përgjigjja, para. 2, 19, 22(a).

<sup>19</sup> Përgjigjja, para. 2, 14 19, 22(b).

<sup>20</sup> Përgjigjja, para. 3.

<sup>21</sup> Kundërpërgjigjja, para. 1.

<sup>22</sup> Kundërpërgjigjja, para. 2, poshtëshënimi 4 që tregon se kjo do të rezultojë në heqjen e 29 shënimeve nga Shtojca 1 e Kërkesës, f. SPOE00408883-00408889.

<sup>23</sup> Kundërpërgjigjja, para. 2.

<sup>24</sup> Kundërpërgjigjja, para. 3.

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas rregullës 133, pas mbylljes së paraqitjes së provave të Mbrojtjes sipas rregullës 131, ose pasi të jenë dëgjuar dëshmitë e thirrura nga trupi gjykues, kryegjykatësi i trupit gjykues i pyet palët nëse kanë mocione për paraqitje të kundërprovave sipas rregullës 127. Leja për të paraqitur prova të tilla do të miratohet në interes të drejtësisë dhe vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

11. Sipas jurisprudencës së juridiksioneve ndërkombëtare të cilat janë referuar nga palët, kundërprovat janë të pranueshme vetëm kur ato i përgjigjen një aspekti të rëndësishëm që buron drejtpërdrejt nga provat e mbrojtjes, i cili nuk mund të ishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme.<sup>25</sup> Për rrjedhojë, në rrethanat kur prokuroria duhet të kishte parashikuar aspektin përkatës dhe i ka paraqitur provat e saj si palë thirrëse, kundërprovat nuk janë të pranueshme.<sup>26</sup> Trupi Gjykues do të mbështetet në këtë standard, në të cilin të dyja palët duket se mbështeten,<sup>27</sup> për vlerësimin e Kërkesës dhe nëse ajo i përmbush kriteret e rregullës 133.

---

<sup>25</sup> Shih p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al*, IT-96-21-A, [Judgement](#) ("Delalić Appeal Judgment"), 20 February 2001, para. 273; *Prosecutor v. Kordić & Čerkez*, IT-95-14/2-A, [Judgement](#), 17 December 2004, paras 220-221; ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, [Decision on Prosecution's Motion for Leave to Amend its Exhibit List](#), 19 October 2011, para. 20; *Prosecutor v. Krstić*, IT-98-33-T, [Decision on the Defence Motions to Exclude Exhibits in Rebuttal and Motion for Continuance](#), 4 May 2001, para. 11; *Prosecutor v. Limaj et al*, IT-03-66-T, [Decision on Prosecution's Motion to Admit Rebuttal Statements Via Rule 92 bis](#), 7 July 2005, para. 6; *Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, IT-09-69-T, [Decision on Prosecution Motion for Admission of rebuttal evidence regarding witness JF-057](#), 20 September 2012, para. 5. See also ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-2022-Red, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr Ongwen against the Decision of Trial Chamber IX of 4 February 2021 entitled "Trial Judgment"](#), 15 December 2022, paras 363-364; *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06, Trial Chamber I, [Public Redacted Decision on the Prosecution's Application to Admit Rebuttal Evidence from Witness DRC-OTP-WWW-0005](#), 28 April 2011, paras 36, 41-43; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06, Trial Chamber VI, [Decision on Prosecution request for presentation of evidence in rebuttal \(ICC-01/04-02/06-2197-Conf\) and related filings](#), 26 February 2018, para. 20; *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-1623, Trial Chamber IX, [Decision on Requests related to the Testimony of Defence Expert Witnesses D0041 and D-0042](#), 1 October 2019, para. 16.

<sup>26</sup> ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-T, [Decision on Prosecution Motion to Call Rebuttal Evidence](#), 21 July 2005; *Prosecutor v. Orić*, IT-03-68-T, [Decision on the Prosecution Motion With Addendum and Urgent Addendum to Present Rebuttal Evidence Pursuant to Rule 85\(A\)\(iii\)](#), 9 February 2006, p. 3; *Prosecutor v. Lukić & Lukić*, IT-98-32/1-T, [Decision on Motion for Reconsideration or Certification to Appeal the Decision on Rebuttal Witnesses](#), 9 April 2009, para. 18; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 56.

<sup>27</sup> Shih Kërkesën, para. 2, poshtëshënimi 22; Përgjigja, para. 5, poshtëshënimi 6-7.

#### IV. DISKUTIM

12. Sipas rregullës 133, Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse ZPS-demonstroj se një rrethanë e jashtëzakonshme për ligj miratimin e Kërkesës dhe nëse miratimi i Kërkesës është në interes të drejtësisë. Për t'u ndihmuar për të marrë këtë vendim, Trupi Gjykses duhet të bindet se provat e propozuara: (i) lidhen me një aspekt të rëndësishëm; (ii) që buron drejtpërdrejt nga provat e Mbrojtjes; (iii) që nuk mund të ishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme.<sup>28</sup>

13. Trupi Gjykses rikujton se ZPS-ja argumenton se Kërkesa duhet të miratohet në rrethana të jashtëzakonshme pasi provat e propozuara kanë fushëveprim të kufizuar, janë të llojit dokumentar, dhe lidhen me një aspekt të veçantë që buron drejtpërdrejt nga provat e pranuar të Mbrojtjes.<sup>29</sup> Konkretisht, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja parashtrohet se: (i) Tabela fillimisht ishte pjesë e materialit 115;<sup>30</sup> (ii) materiali 123 jep hollësi në lidhje me procesin e krijimit të një kopje digjitale forenzike nga e cila janë marrë materialet e renditura në tabelë;<sup>31</sup> dhe (iii) materiali 124 përshkruan se si dokumentet e fshira u rikuperuan dhe u nxorën nga kompjuteri.<sup>32</sup> ZPS-ja vëren se nga këto dokumente të fshira, shtatë janë pranuar në prova ("shtatë dokumentet e pranuar").<sup>33</sup> ZPS-ja parashtrohet se tabela: (i) përfshin në faqen e fundit të saj të shtatë dokumentet e pranuar dhe ERN-të përkatëse;<sup>34</sup> (ii) identifikon materialet;<sup>35</sup> dhe (iii) lidh materialet 123-124 me prova

---

<sup>28</sup> *Shih Delalić Appeal Judgment*, para. 273 me referencat e cituara më lart në poshtëshënimin 11.

<sup>29</sup> Kërkesa, para. 2-3.

<sup>30</sup> Kërkesa, para. 3(a).

<sup>31</sup> Kërkesa, para. 3(b).

<sup>32</sup> Kërkesa, para. 3(c).

<sup>33</sup> P01110 (SPOE00248501-00248501), P00613 (SPOE00248502-00248502), P00611 (SPOE00248503-00248503), P02913 (SPOE00248504-00248504), P02772 (SPOE00248505-00248505), P00610 (SPOE00248506-00248506), dhe P01174 (SPOE00248507-00248507). *Shih gjithashtu* Tabelën, f. 10; materialin 124, f. 113733.

<sup>34</sup> Kërkesa, para. 3(c), që i referohet Shtojcës 1 të Kërkesës, f. SPOE00408890.

<sup>35</sup> Kërkesa, para. 4.

të tjera të pranuar.<sup>36</sup> Së fundi, ZPS-ja parashtron se provat e propozuara jep kontekst minimal të domosdoshëm për të kuptuar relevancën dhe peshën që do t'u jepet këtyre materialeve.<sup>37</sup>

14. Mbrojtja përgjigjet se ZPS-ja nuk ka demonstruar rrethana të jashtëzakonshme që përlligjin Kërkesën.<sup>38</sup> Mbrojtja parashtron, në veçanti, se ZPS-ja: (i) është mbështetur, ose mund të ishte mbështetur, në provat e propozuara përpara përfundimit të paraqitjes së provave të saj;<sup>39</sup> dhe (ii) ishte në dijeni se Mbrojtja kundërshtonte prejardhjen e kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të materialeve të sekuestruara nga kompjuteri.<sup>40</sup> Mbrojtja gjithashtu mendon se provat e propozuara nuk përbëjnë kundërprova.<sup>41</sup> Në vend që t'i kundërshtojnë materialet, provat e propozuara thjeshtë i plotësojnë ato.<sup>42</sup> Mbrojtja parashtron se, përmes paraqitjes për pranim të provave të propozuara, ZPS-ja kërkon të japë informacion shtesë me vonesë, të cilin ajo mund ta kishte paraqitur gjatë paraqitjes së provave të saj gjatë gjykimit.<sup>43</sup>

15. Sa i përket rëndësisë së aspektit, Trupi Gjykses vëren se provat e propozuara nuk kanë të bëjnë me ndonjë aspekt me rëndësi materiale në këtë çështje. Megjithatë, në masën që provat e propozuara lidhen me materialet dhe sekuestrimin e kompjuterit, dhe më gjerësisht nëse materiali i është sekuestruar z. Krasniqi, Trupi Gjykses konsideron se aspekti mund të konsiderohet i rëndësishëm. Për këtë arsye, në ushtrim të diskrecionit të vet, Trupi Gjykses është i gatshëm të pranojë se provat e propozuara lidhen me një "aspekt të rëndësishëm".

---

<sup>36</sup> Kërkesa, para. 4.

<sup>37</sup> Kërkesa, para. 4.

<sup>38</sup> Përgjigja, para. 5-9.

<sup>39</sup> Përgjigja, para. 6, 9.

<sup>40</sup> Përgjigja, para. 7, 9.

<sup>41</sup> Përgjigja, para. 10.

<sup>42</sup> Përgjigja, para. 11-12.

<sup>43</sup> Përgjigja, para. 10-13.



16. Sa i përket nëse pika buron drejtpërdrejt nga provat e Mbrojtjes, Trupi Gjykses vëren se është e qartë nga Kërkesa se ZPS-ja kërkon pranimin e provave të propozuara në mënyrë që të kundërshtojë materialet.<sup>44</sup> Ndryshe nga parashtrimi i ZPS-së, Trupi Gjykses nuk është bindur se provat e propozuara lidhen me një aspekt që buron drejtpërdrejt nga materialet.<sup>45</sup> Trupi Gjykses vëren se, sipas parashtrimit të vetë ZPS-së, ZPS-ja fillimisht ia dërgoi tabelën Mbrojtjes së Krasniqit në qershor 2023, bashkëlidhur materialit 115, në përgjigje të kërkesës së Mbrojtjes së Krasniqit lidhur me ekzaminimin forenzik të kompjuterit (“Kërkesa e Krasniqit”).<sup>46</sup> Rezulton se tabela ishte e disponueshme gjatë të gjithë kohës për ZPS-në.<sup>47</sup> Trupi Gjykses gjithashtu vëren se, për më tepër, Mbrojtja e Krasniqit gjatë paraqitjes së provave të ZPS-së e ka ngritur shumë herë se ajo kundërshtonte prejardhjen (dhe mbështetshmërinë) e materialeve të sekuestruara nga kompjuteri.<sup>48</sup> Me fjalë të tjera, çështja e mbështetshmërisë dhe prejardhjes së materialeve të sekuestruara ishte aspekt i diskutuar gjatë paraqitjes së provave nga ZPS-ja. Për këto arsye, Trupi Gjykses vlerëson se ZPS-ja nuk ka demonstruar se provat e propozuara lidhen me një aspekt të rëndësishëm që buron drejtpërdrejt nga provat e paraqitura nga Mbrojtja.<sup>49</sup>

17. Sa i takon nëse pika mund të ishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme, Trupi Gjykses vëren krahas sa më lart se, siç tregohet nga ZPS-ja, Tabela përmban: (i) informacion në lidhje me materialet në listën e provave materiale të ZPS-së të marra nga kompjuteri - “shumë [prej të cilave] janë pranuar”; dhe (ii) krahason dokumentet e morën nga kompjuteri me ato të pranuar në proces.<sup>50</sup> Duke marrë

---

<sup>44</sup> *Shih* Kërkesën, para. 3.

<sup>45</sup> *Shih* Kërkesën, para. 3.

<sup>46</sup> *Shih* Kërkesën, para. 3(a).

<sup>47</sup> *Krahaso me* ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, IT-03-69-T, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Rebuttal Evidence: Serbian DB Personnel Files](#), 31 October 2012, para. 8; *Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, IT-03-69-T, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Rebuttal Evidence: Mladic Notebooks](#), 31 October 2012, para. 9.

<sup>48</sup> *Shih* materialin 115; Përgjigja, para. 7, poshtëshënimi 11.

<sup>49</sup> *Shih* Kërkesën, para. 3.

<sup>50</sup> *Shih* Kërkesën, para. 1, poshtëshënimi 3, dhe para. 4.



parasysh kundërshtimet e ngritura nga Mbrojtja gjatë paraqitjes së provave nga ZPS-ja në lidhje me materialet e sekuestruara nga kompjuteri;<sup>51</sup> dhe faktin se tabela ishte lirisht në dispozicion të ZPS-së *ab initio* gjatë paraqitjes së provave prej saj,<sup>52</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se ZPS-ja mund të kishte parashikuar nevojën për të paraqitur provat e propozuara gjatë paraqitjes së provave të saj.<sup>53</sup> Trupi Gjykses vëren se, pasi është vënë në dijeni të kundërshtimit të prejardhjes dhe mbështetshmërisë nga Mbrojtja e Krasniqit, ZPS-ja mund të kishte kërkuar leje për ndryshimin e listës së provave materiale të saj për të shtuar dhe për të paraqitur këto materiale si pjesë të provave të saj.

18. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që përlligjin miratimin e Kërkesës.

19. Së fundi, Trupi Gjykses vëren argumentet e ZPS-së se pranimi i provave të propozuara do të ishte në interes të drejtësisë pasi: (i) ato japin kontekstin e domosdoshëm për të kuptuar relevancën dhe peshën që u duhet dhënë materialeve;<sup>54</sup> dhe (ii) pa to, palët nuk do kenë mundësi të japin sqarimet e kërkuara nga Trupi Gjykses në Vendimin për Provat Jogojore të Krasniqit.<sup>55</sup> Trupi Gjykses ka treguar tashmë se natyra e saktë e argumentit të ngritur nga Mbrojtja e Krasniqit në lidhje me prejardhjen dhe mbështetshmërinë e materialit të sekuestruar nga kompjuteri i z. Krasniqi nuk është e qartë dhe ka evoluar gjatë gjithë procesit. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka vërejtur tashmë se ai do të mirëpriste sqarime të tjera “në parashtrimet përfundimtare të palëve” lidhur me këtë pikë.<sup>56</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja: (i) ka pasur mundësi të bëjë parashtrime lidhur me relevancën e materialeve në përgjigjen e saj ndaj Mocionit

---

<sup>51</sup> *Shih* Përgjigjen, para. 7, poshtëshënimi 11.

<sup>52</sup> *Shih më lart*, para. 16.

<sup>53</sup> *Shih contra* Kërkesën, para. 5.

<sup>54</sup> *Shih* Kërkesën, para. 4.

<sup>55</sup> *Shih* Kërkesën, para. 5 që i referohet Vendimit për Provat Jogojore të Krasniqit, para. 75.

<sup>56</sup> Vendimi mbi Provat Jogojore të Krasniqit, para. 75.

të Provave Jogojore të Mbrojtjes së Krasniqit, dhe e ka bërë këtë;<sup>57</sup> dhe (ii) do të ketë mundësi të bëjë parashtrime në lidhje me relevancën, autenticitetin, peshën dhe vlerën provuese të materialeve në dosjen gjyqësore përfundimtare të saj. Gjithashtu, ftesa e Trupit Gjyqësor për sqarim në dosjet gjyqësore përfundimtare nuk ishte ftesë për paraqitjen e provave shtesë, përkundrazi ishte ftesë për palët për të artikuluar provat e tyre me qartësi për t'i mundësuar Trupit Gjyqësor të kuptojë argumentet e tyre dhe të vendosë lidhur me to.<sup>58</sup> Siç tregohet nga ZPS-ja, provat e propozuara thjesht do të japin kontekst shtesë lidhur me dokumentet dhe do t'i lidhin ato me prova të tjera të pranuar të ZPS-së.<sup>59</sup> Kjo mund të bëhet në mënyrë të përshtatshme në parashtrimet përfundimtare. Për këto arsye, Trupi Gjyqësor gjykon se ZPS-ja gjithashtu nuk ka demonstruar se pranimi i provave të propozuara është në interes të drejtësisë.

20. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjyqësor gjykon se ZPS-ja nuk ka demonstruar se Kërkesa është në interes të drejtësisë dhe që duhet të miratohet në rrethana të jashtëzakonshme.<sup>60</sup> Për rrjedhojë, Trupi Gjyqësor e rrëzon Kërkesën.

## V. KLASIFIKIMI

21. Trupi Gjyqësor vëren parashtrimin e Mbrojtjes së Krasniqit se Përgjigjja (F03620) është konfidenciale pasi ajo lidhet me përmbajtjen e materialit provues të klasifikuar si konfidencial.

22. Trupi Gjyqësor urdhëron Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes (F03620) deri **të hënën, 19 janar 2026**.

---

<sup>57</sup> Shih F03573, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Dytë të Mbrojtjes së Krasniqit për Pranimin e Provave Jogojore (F03556)*, 10 nëntor 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>58</sup> Vendimi mbi Provat Jogojore të Krasniqit, para. 75.

<sup>59</sup> Shih Kërkesën, para. 5.

<sup>60</sup> Shih Kërkesën, para. 5.

VI. VENDIM

23. Trupi Gjykues:

- a) **RRËZON** Kërkesën.
- b) **REFUZON** pranimin e provave të propozuara; dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes (F03620) deri **të hënën, 19 janar 2026**.

/nënshkrimi/

**Gjykatësi Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E enjte, 18 dhjetor 2025

Në Hagë, Holandë.